



Përditësim për shtypin

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në gjykimin e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, më 27 mars u bë publik versioni i redaktuar publik i dosjes përfundimtare të Hashim Thaçit. Në dosjet e tyre përfundimtare palët paraqesin përmbledhje të fakteve kryesore, provave dhe argumenteve të tyre ligjore.

Në gjykimin e Hashim Thaçit, Bashkim Smakajt, Isni Kilajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit, të pesë ekipet e Mbrojtjes e kanë njoftuar tashmë Gjykatësin e Vetëm nëse synojnë të paraqesin prova gjatë gjykimit. Dje, më 1 prill, u mbajt seanca përgatitore për Mbrojtjen, gjatë së cilës u mësuan më shumë hollësi lidhur me provat e ekipeve të Mbrojtjes.

Ekipet e Mbrojtjes së Thaçit dhe Kilajt synojnë të paraqesin prova dhe kanë dorëzuar listat e dëshmitarëve dhe të provave materiale. Mbrojtja e z. Thaçi synon të dorëzojë dëshminë e një dëshmitari me shkrim. Në bazë të Rregullores, Gjykatësi i Vetëm mund të vendosë që dëshmitari të vijë në sallën e gjyqit për pyetje nga pala kundërshtare.

Gjatë seancës, Gjykatësi i Vetëm theksoi gjithashtu se dy raportet e dorëzuara nga Mbrojtja e Thaçit duket të jenë aktekspertiza për të cilat zbatohet rregulla 149. Kjo nënkupton se, në qoftë se pala kundërshtare, në këtë rast Prokuroria, nuk i pranon raportet, mund të jetë e nevojshme që autorët e këtyre raporteve të japin dëshmi në Gjykatë.

Krahas provave që do të paraqiten nga Mbrojtja e z. Thaçi, Mbrojtja e Kilajt synon të dorëzojë dëshmitë me shkrim të katër dëshmitarëve që lidhen me karakterin e z. Kilaj.

Ekipet e Mbrojtjes së z. Smakaj, z. Fazliu dhe z. Kuçi nuk do të paraqesin prova.

Për shkak se ende nuk është marrë vendim lidhur me pranimin e dëshmimeve me shkrim dhe, për rrjedhojë, nuk dihet nëse do ketë dëshmitarë që do të japin dëshmi në Gjykatë, Gjykatësi u kërkoi palëve të jenë të disponueshme për një seancë të mundshme më 14 dhe 15 prill 2026 dhe anuloi seancat e planifikuara para këtyre datave. Gjithashtu, ai urdhëroi Mbrojtjen e Thaçit të dorëzonte kërkesë lidhur me dëshminë e ekspertit brenda ditës së sotme, më 2 prill, duke vënë në dukje se afati për dorëzimin e këtyre kërkesave ishte dje.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, më 30 mars doli versioni i redaktuar publik i Vendimit të Gjykatësit të Vetëm, i datës 19 mars, lidhur me kërkesën e Prokurorisë për të pranuar disa fakte si fakte të njohura gjerësisht. Në





vendim, Gjykatësi e rrëzoi kërkesën, pasi Prokuroria nuk kishte argumentuar mjaftueshëm se si faktet e propozuara ishin relevantë për akuzat.

Më 31 mars, Gjykatësi i Vetëm miratoi kërkesën e Prokurorisë për zgjatjen e afatit për t'iu përgjigjur një mocioni të Mbrojtjes së Thaçit, në të cilin kërkonte që dëshmia e një dëshmitari të jepej vetëm me shkrim. Gjykatësi e miratoi zgjatjen e afatit, pasi konstatoi se Prokuroria kishte paraqitur arsye të vlefshme dhe mbajti parasysh se Mbrojtja e Thaçit nuk paraqiti kundërshtime, me kusht që të zgjatej edhe afati i saj për t'iu kundërpërgjigjur. Gjykatësi caktoi si afat të ri datën 8 prill për përgjigjen e Prokurorisë dhe datën 13 prill për kundërpërgjigjen e Mbrojtjes.

Gjithashtu, më 31 mars, Administratorja njoftoi Gjykatësin e Vetëm se kishte caktuar z. Derrik Gudën (Derrick Gooden) si bashkëmbrojtës të z. Bashkim Smakaj.

Në çështjen e *Pjetër Shalës*, Kryetarja e DHSK-së, Ekaterina Trendafilova, më 25 mars caktoi panelin e Gjykatës Kushtetuese për të vendosur lidhur me zgjatjen e afatit për dorëzimin e kërkesës referuese në Gjykatë Kushtetuese. Kryetare Trendafilova caktoi gjykatësit Vidar Stensland, Rumen Nenkov dhe Pjotr Hofmanski. Më 31 mars, Paneli miratoi pjesërisht kërkesën e z. Shala dhe caktoi 1 qershorin si datë deri në të cilën z. Shala duhet të dorëzojë kërkesën referuese.

Për kujtesë: në korrik 2024, Trupi Gjykues e shpalli z. Shala fajtor për krimet e luftës të ndalimit arbitrar, torturës dhe vrasjes së paligjshme për ngjarje që ndodhën në maj dhe qershor 1999 në fabrikën e metalit në Kukës, ku viktimat, kryesisht shqiptarë të Kosovës, u mbajtën në kushte çnjerëzore dhe degraduese, u keqtrajtuan psikologjikisht dhe fizikisht dhe keqtrajtimi brutal i la të ndaluarit me pasoja afatgjata fizike dhe mendore. Një prej të ndaluarve u qëllua me armë nga një anëtar i UÇK-së, pasi ishte keqtrajtuar disa herë nga një grup anëtarësh të UÇK-së. Ai vdiq si pasojë e plagëve të shkaktuara me armë zjarri, ndërthurur me refuzimin e trajtimit të duhur mjekësor.

Trupi Gjykues u akordoi dëmshpërblim tetë viktimave pjesëmarrëse në proces dhe urdhëroi z. Shala të paguajë shumën prej 208,000 eurosh si kompensim për dëmin fizik, mendor dhe material të pësuar prej tyre.

Paneli i Apelit konfirmoi vendimin e fajësisë së tij, por uli dënimin e njëzuar nga 18 në 13 vjet burgim, duke llogaritur kohën e kaluar në paraburgim.

